



Marcie Ries: "Populli Amerikan dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë shumë të angazhuar për të mbështetur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar si dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri".

**PERSHENDETJA E
AMBASADORES
AMERIKANE NE TIRANE,
ZNJ. MARCIE RIES NË
VIZITEN E BERE NE
FABRIKEN "MIRËSIA"**

Integrimi i plotë i shqiptarëve me aftësi të kufizuar në shoqëri do të kërkojë një përpjekje të ndjeshme, por është një qëllim shumë i mirë, dhe dua t'ju them se Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të vazhdojë të mbështesë këtë qëllim.

Faqe 3

**E DREJTA KUSHTETUESE
E PËRFSHIRJES NË
PROCESET ZGJEDHORE
- E DREJTË E
BARABARTË PËR TË
GJITHË QYTETARËT**

Per here te pare ne historine e proceseve zgjedhore ne Shqiperi, ne zgjedhjet e 3 Korrik 2005, KQZ mundesoi me shume akses per votim te barabarte, te drejtperdrejte e te fshehte per personat me aftesi te kufizuar.

Faqe 14

**APLIKIM I POLITIKAVE
SUBVENCIONUESE
TE SHTETIT
SHQIPTAR PER
PERSONAT ME AFTESI
TE KUFIZUAR**

Miratimi i fondit per here te dyte nga Qeveria Shqiptare per prodhimin e mjeteve levizese ne punishten "Miresia", e vetmja e ketij lloji ne vendin tone, ka kontribuar drejtpersdrejti ne vazhdimesine e nje projekti social.

Faqe 6

Editorial

Fjalimi i ambasadores se SHBA ne Tirane, Znj. Marcie Ries mbajtur ne Fabriken "Miresia" 3

Sherbime mbeshtetese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi ne nevoje per karrike me rrota. 4

Projekti i financuar nga Leah War Victims Fund, nje fond i Qeverise amerikane synon te rrisë numrin e personave me aftesi te kufizuara te cilet do te mund te perdorin mjete levizese ne funksion te shtimit te mundesive per integrim ne ambientin shoqeror ku jetojne.

Aplikim i politikave subvencionuese te shtetit shqiptar per personat me aftesi te kufizuar 6

Miratimi i fondit per here te dyle nga Qeveria Shqiptare per prodhimin e mjeteve levizese ne punishten "Miresia", e vetmja e ketij lloji ne vendin tone, ka kontribuar drejtpersedrejt ne vazhdimesine e nje projekti social.

Programi, "Avokati dhe asistence ligjore per PAK" edhe ne 5 qytete te Shqiperise 8



Draft – Konventa gjithperفشirese dhe integrale ne mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave dhe dinjitetit te personave me aftesi te kufizuar 9

Per Aftesine e Kufizuar mendore dora e shtetit nuk ekziston 11

E drejta kushtetuese e perfshirjes ne proceset zgjedhore – e drejte e barabarte per te gjithë qytetaret 14

Per here te pare ne zgjedhjet e 3 Korrik 2005, KQZ mundesoi me shume akses per votim te barabarte, te drejtperdrejte e te fshehte per personat me aftesi te kufizuar.

Ndertimi pa barriera dhe specialistet 16

Krahas fushatave ndergjegjesuese, te kerkohet aplikimi masiv i rregullave të Urbanistikës e të Arkitekturës, për Personat me Aftësi të Kufizuar, si detyrim ligjor, ndaj shkeljes se te cilit te mbahet i njejti qendrim si per çdo shkelje tjeter ligjore

p ë r m b a j t j a



Indrit Hazizolli, i mituri elbasanas qe u ben thirrje mjekeve ta shpetojne nga karrikja me rrota 18

Per nje rol me aktiv te shoqerise civile per zbatimin e strategjise Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuar 20

FSHDPAK, promotore per hartimin dhe aprovimin e Strategjise Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuara (SKAK), vazhdon te luaj rol nismetar, tashme per te nxitur implementimin e saj.

A e dini se... 22

Si te gatuajme receta te reja 22

Revistë e përtremuajshme

Financuar nga:
Komiteti Suedez i Helsinkit
për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Bashkëpunëtorë:

Bardhylka Kospiri
Juli Shllaku
Narbis Ballhysa
Florida Kalemi
Entila Zyba
Brikena Demiras
Fatmir Popja
Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë

Design
Orest Muça

Adresa:
Rruga: "Mujo Ulqinaku"
Nr.26 Tiranë

Tel.Fax:
++355 4 266892

E-mail: adrf@icc.al.eu.org
www.adrf.org.al

PERSHENDETJA E AMBASADORES AMERIKANE NE TIRANE, ZNJ. MARCIE RIES NË VIZITEN E BERE NE FABRIKEN "MIRËSIA" 2 qershor 2005

Mirëmëngjes të gjithëve!
Ministër Bejtja dhe të
Nderuar të Ftuar!

Përgëzoj Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për punën që ka bërë në përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuar. Populli Amerikan dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë shumë të angazhuar për të mbështetur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, të drejtat e këtyre personave këtu, si dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Fondi që ne i akorduar FSHDPAK-së është mundësuar nga Leah War Victims Fund, i cili siguron 14 milion \$ për personat me aftësi të kufizuar në mbarë botën. Unë jam shumë e kënaqur që sot kemi këtu një përfaqësues të këtij Fondi. Ai është Z.Lloyd Finenberg, i cili ndodhet këtu krah meje, dhe dëshiroj ta falenderoj për ardhjen dhe mbështetjen e kësaj iniciative.

Pra çfarë po bëjmë ne me këtë fond? Po prodhojmë karrike me rrota, ofrojmë shërbime më të mira rehabilituese, bëjmë advokasi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, dhe rrisim ndërgjegjësimin e publikut. Dëshiroj t'iu tregoj dicka, një arsye personale përse unë ndihem kaq e dhënë pas kësaj organizate. Rreth 9 vite më parë babai im u bë person me aftësi të kufizuara. Dhe ai nuk ishte në gjendje të ecte, dhe përdorte karriken me rrota. Dhe duke kaluar kohën me të në Shtetet e Bashkuara, unë fillova të kuptoj sesa e rëndësishme është të bëhet një përpjekje e veçantë për t'iu kujdesur për personat me aftësi

të kufizuar apo që të ndërtohet për këta njerëz, për të bërë të mundur që ata të kenë një jetë normale, të punojnë, të vizitojnë miqtë si dhe të bëjnë gjëra të tjera që i bëjnë të gjithë. Dhe kjo është një përpjekje e vazhdueshme për të cilën ne duhet të punojmë. Kjo është arsyeja që unë jam shumë e kënaqur me punën e Fondacionit si dhe me kontributin që mund të japin Shtetet e Bashkuara për këtë punë.

Ky Fondacion ka ngritur qendren e parë burimore për personat me aftësi të kufizuar, familjarët e tyre, shpërndarësit e shërbimit dhe kërkuesit, dhe ka siguruar për OJQ-të informacion, trainime dhe mbështetje teknike, duke përfshirë dhe paisjen e 1500 personave me karrike me rrota. Dhe natyrisht, duke e ditur nga përvoja ime, siguri i informacionit është shumë i rëndësishëm. Egzistenca e një qendre burimore, ku mund të shkosh dhe të të ndihmojnë është vërtetë kritike.

Fondacioni gjithashtu ka hartuar dhe ka lobuar në mënyrë të suksesshme për legjislacionin mbi aftësinë e kufizuar, çfarë ka bërë të mundur aprovimin e Strategjisë Kombëtare mbi Aftësinë e Kufizuar. Ky është një hap i rëndësishëm përpara dhe një arritje e rëndësishme. Strategjia Kombëtare mbi Aftësinë e Kufizuar, e cila u bë e njohur në janar tregon vullnetin e Qeverisë

SFIDA 19

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUAR



Shqiptare për të vepruar në të mirë të personave me aftësi të kufizuar. Por Strategjia kërkon gjithashtu që të veprohet, me qëllim që shqiptarët që kanë shumë nevojë të përfitojnë. Aksesit i barabartë për arsim dhe shanse të barabarta janë shumë të rëndësishme, po ashtu si dhe aksesit i plotë për shërbime mjekësore dhe sociale.

Natyrisht që komunitetit të biznesit i duhet të luaj rol në të. Komuniteti i biznesit mund të tregojë përgjegjësinë e tij qytetare dhe angazhimin e tij ndaj shqiptarëve me aftësi të kufizuar. Për shembull, duke dhuruar karrike me rrota apo paisje të tjera, duke projektuar ndërtesa që janë të aksesueshme apo duke i paisur ndërtesat e tyre me ambiente pune të cilat të plotësojnë kërkesat e posaçme të personave me aftësi të kufizuar. Dhe unë shpresoj që ata do ta bëjnë këtë gjë.

Integrimi i plotë i shqiptarëve me aftësi të kufizuar në shoqëri do të kërkojë një përpjekje të ndjeshme, por është një qëllim shumë i mirë, një qëllim që mund të arrihet, dhe dua t'ju them se Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të vazhdojë të mbështesë këtë qëllim.

Jam shumë e kënaqur që jam këtu, sot. Shpresoj të kem shansin të flas me disa prej jush pas kësaj.

Shumë faleminderit.

SHERBIME MBESHTETESE PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR NE SHQIPERI NE NEVOJE PER KARRIKE ME RROTA

Ne vijimesi te iniciati vave dhe projekteve te suksesshme te ndermarra nga Fondacioni Shqiptar i te Drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuara, ne 3 qershor 2005 ne ambientet e punishtes MIREZIA u organizua nje ceremoni me rastin e fillimit te zbatimit te projektit „Sherbime mbeshtetese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi ne nevojë per karrike me rrota”. Projekti eshte financuar nga Leah War Victims Fund, nje fond i Qeverise amerikane qe u vjen ne ndihme personave me aftesi te kufizuar ne te gjithe boten. Ky projekt i FSHDPAK synon te rrise numrin e personave me aftesi te kufizuara te cilet do te mund te perdorin mjete levizese ne funksion te shtimit te mundesive per integrim ne ambientin shqeror ku jetojne.

Ne vleresim te arritjeve qe tashme jane shenuar gjate veprimtarise gati 10 vjecare te FSHDPAK, ne ceremonine e organizuar ne pushishten ku prodhohen keto mjete levizese, merrte pjese ambasadorja e SHBA ne Shqiperi zj. Marcie Ries, Ministri i Punes



dhe Çeshtjeve Sociale z. Engjell Bejtja, drejtori i USAID per Shqiperine z. Harry Birnholtz, Z.Lloyd Finenberg, perfaqesues i fondit Leah War Victims Fund, drejtori i Institutit te Sigurimeve Shoqerore z. Ilir Beqja si dhe perfaqesues te shoqatave te personave me aftesi te kufizuara dhe institucioneve shteterore qe merren me ndihmen sociale, ne cilesine e partnereve te zbatimit te projekteve te FSHDPAK.

Zj. Blerta Çani, drejtore

ekzekutive e FSHDPAK, ne pershendejtjen e saj falenderoi USAID per kontributin financiar qe po jep ne zbatimin e ketij projekti. Duke radhitur arritjet dhe veshitresite ne angazhimin e FSHDPAK ne garantimin e sa me shume hapesirave integruese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi, zj. Çani vleresoi kontributin gjithmone e ne rritje te mjaft aktoreve shteterore dhe civile ne kujdesin e veçante per kete kategori personash.

Projekti i financiar nga Leah War Victims Fund, nje fond i Qeverise amerikane synon te rrisë numrin e personave me aftesi te kufizuara te cilet do te mund te perdorin mjete levizese ne funksion te shtimit te mundesive per integrim ne ambientin shoqeror ku jetojne.

Ambasadorja e SHBA ne Shqiperi zj. Ries ne fjalen e saj beri prezent angazhimin e popullit amerikan dhe Qeverise se SHBA per t' u ardhur ne ndihme e per te mbeshetur te drejtat dhe integrimin e personave me aftesi te kufizuar ne shoqeri. Duke vleresuar punen e FSHDPAK per prodhimin e mjeteve levizese nepermjet punishtes Miresia nga vete personat me aftesi te kufizuar, veprimtarine e qendres burimore informuese, lobimin qe ky Fondacion i beri hartimit te Strategjise Kombetare te PAK, zj. Ries tha se personalisht e ndien veten pjese te kesaj eksperience. Ndihma qe ajo i kish ofruar babait te saj te gjendur ne nje karrike me rrota vite me pare e kish bere te kuptonte se sa e rendesishtme eshte per keta njerez pershtatshmeria e ambienteve publike ne pergjithesi per t' i bere ata pjese te jetes se perditshme. Duke nxitur nje mbesh-



SHIDA 19

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PER TE DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR

tetje gjithmone e me te madhe te institucioneve shtetore dhe komunitet te biznesit ndaj ketyre njerezve, zj. Ries siguroi mbeshetjen e Qeverise amerikane ne integrimin e plote te personave me aftesi te kufizuar ne shoqerine shqiptare.

Ne kete ceremoni pershendeten dhe Z. Harry Birnholtz, Drejtor i USAID ne Shqiperi dhe Z. Lloyd Finenberg, perfaqesues i fondit Leah War Victims Fund , Z. Engjell Bejtja te cilet gjithashtu shprehen besimin ne realizimin e suksesshem te ketij projekti nga FSHDPAK.

Te ftuarit ne kete ceremoni paten rastin te shkembenin mendime dhe ndanin emocione me personat me aftesi te kufizuar qe punojne ne punishten Miresia si dhe me disa femije PAK qe kane mundur te sigurojne mjete levizese fale prodhimeve te kesaj punishteje. Ambasadorja Ries, perfaqesuesit e USAID dhe institucioneve shtetore u njohen nga afer me ambientet e punes ne kete punishte dhe vleresuan kushtet dhe frymen integruese qe FSHDPAK u ka ofruar ketyre personave fale zbatimit te projekteve te saj.

Aplikim i politikave subvencionuese te shtetit shqiptar per personat me aftesi te kufizuar

Ne ambientet e fabrikes “Miresia”, program i Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar (FSHDPAK) me 27.06.2005 u nenshkrua kontrata ndermjet ketij fondacioni dhe Institutit te Sigurimeve Shoqerore per prodhimin e 200 karrikeve me rrota per invalide te punes ne skemat e sigurimeve shoqerore. Kontrata u firmos nga Drejtori i Pergjithshem i Institutit te Sigurimeve Shoqerore, Z. Ilir BEQJA dhe Drejtori Ekzekutiv i FSHDPAK, Znj. Blerta ÇANI.

Kjo kontrate e dyta e ketij lloji mbeshtetet ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.204, date 07.04.2005 per akordimin fondit prej 5.000.000 (pese milion) leke, per prodhimin e mjeteve levizese per invalide.

Miratimi i fondit per here te dyte nga Qeveria Shqiptare per prodhimin e mjeteve levizese ne punishten “Miresia”, e vetmja e ketij lloji ne vendin tone, ka kontribuar drejtperdrejti ne vazhdimesine e nje projekti social permes te cilit realizohen objektiva integrimi per personat me aftesi te kufizuar te tilla si: ofrimi i sherbimeve direkte, karrike me rrota per persona me aftesi te kufizuar ne nevoje per to si dhe ofrimi i shanseve per punesim; ne punishten “Miresia” jane te punesuar persona me aftesi te kufizuar, perdorues te karrikeve me rrota.

Mbeshtetja e dhene nga qeveria shqiptare per nje pro-



jekt te tille ka mundesuar aplikimin per here te pare ne Shqiperi te politikave subvencionuese per personat me aftesi te kufizuar ne nevoje per sherbime mbeshtetese per te cilet shteti ka detyrim ligjor.

Partneriteti ne vazhdimesi ndermjet strukturave shteter-

ore dhe FSHDPAK ne ofrimin e sherbimeve mbeshtetese per PAK eshte garanci per ecuri pozitive ne drejtim te plotesimit te nevojave te nje numri ne rritje te PAK ne nevoje per mjete levizese duke mundesuar nxitjen e zhvillimit te programeve te cilat promovojne te

Nr.	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore	Nr. i karrikeve te shperndara
1.	Berat	32
2.	Diber	35
3.	Durres	39
4.	Tirane	14
5.	Elbasan	15
6.	Fier	33
7.	Gjrokaster	14
8.	Korçe	30
9.	Kukes	1
10.	Lezhe	17
11.	Shkoder	19
12.	Vlore	12

drejtat e personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi e me ndikim te drejtperdrejte ne rritjen e cilesise se jetes se tyre.

FSHDPAK bashkepunoj ngushtesisht me Zyrat Rajonale te Sigurimeve Shoqerore ne te gjithe vendin per te shperndare 200 karriket me rrota sipas afateve kohore te percaktuara ne kontrate dhe nevojave te invalideve te

punes per to. Bazuar ne kete praktike te filluar, duke njohur nevojat ne rritje te personave me aftesi te kufizuar per mjete levizese si pasoje e faktoreve te ndryshem si dhe duke vleresuar mundesite e shtetit shqiptar per te perbaluar kosto te limituara per subvencionim te ketij sherbimi, mbeshtetja ne vazhdimesi e Qeverise Shqiptare eshte domosdoshmeri.

SFIDA 19



***Miratimi i fondit
per here te dyte
nga Qeveria
Shqiptare per
prodhimin e
mjeteve levizese ne
punishten
“Miresia”, e vetmja
e ketij lloji ne
vendin tone, ka
kontribuar
drejtpersedrejti ne
vazhdimesine e nje
projekti social.***





FSHDPAK duke dashur t'i vijë në ndihmë, me anë të programeve të saj, PAK dhe familjarëve të tyre edhe në qytete të tjera, përveç Tiranës, nëpërmjet Programit “Avokati dhe Asistencë ligjore për PAK” që prej Janarit 2005 e ka shtrirë veprimtarinë e saj edhe në 5 Qytete të Shqipërisë, në Shkodër, Korçë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë.

Gjatë kësaj periudhe është bërë e mundur lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Drejtuesit e Zyrave të CSDC (Zyra të Shoqërisë Civile, të krijuara nga OSBE) në këto qytete. Lidhja e këtyre marrëveshjeve konsistoi në vendosjen e Juristëve, të kontraktuar nga FSHDPAK, pranë këtyre zyrave me qëllim ofrimin e konsulencës ligjore,

Programi “Avokati dhe Asistencë ligjore për PAK” edhe në 5 qytete të Shqipërisë

ekspertizes të dokumentacionit si dhe Avokat falas për të gjithë ata persona që për shkak të aftësisë të kufizuar, ju është mohuar apo shkelur e drejta nga organe të administratës publike.

Më konkretisht:

- Juristi ofron këshillim dhe asistencë ligjore për të gjitha kategoritë e PAK në zonën që ato mbulojnë, ku përfshihet
- ekspertizë dokumentacioni;
- orjentim dhe udhëzim mbi procedurat apo dokumenta-

**Për më tepër informacion
kontakttoni në adresat
dhe numrat e mëposhtme
të telefonit**

FSHDPAK TIRANË

Rr. "Mujo Ulqinaku", Nr.26, TIRANË,
Shqipëri.

Tel. +3554266892

+3554269426

www.adrf.org.al

e-mail: adrf@icc.eu.org

Dega SHKODËR

pranë zyrave të CSDC

Lagjja "Vasil Shanto", Rruga "Çajupi",
nr. 175.

Dega KORÇË

pranë zyrave të CSDC

Rruga "Kristo Grabocka", Nr.5.

Dega ELBASAN

pranë zyrave të CSDC

Lagjja "Beqir Dardha", Rruga "Luigj
Gurakuqi" pranë tre kullave 41.

Dega Durrës

pranë zyrave të CSDC

Lagjja 6, Rruga "Dëshmorëve",
pall.409.

Dega Vlorë

pranë zyrave të CSDC

Lagjja "29 Nëntori" Rruga "Sadik
Zoraj" Pall. 455.

cionin që duhet të ndiqen
nga PAK për të përfituar të
drejtat e tyre;

- përfaqësim ligjor në mbrojtje të të drejtave të PAK përpara organeve të administratës publike, si KEMP, Sigurime shoqërore; Bashki apo Komuna.
- ju ofron klientëve materiale informuese, broshura, fletëpalosje mbi të drejtat e PAK, të cilat janë pjesë e Qendrës Burimore të FSHDPAK,

Juristi është në shërbimin tuaj 2 ditë në javë me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zgjidhjen e problemeve e ankesave tuaja.

SFIDA 19



Draft-Konventa gjithëpërfshirëse dhe integrale në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Njewe Jork është duke u diskutuar hartimi i një konvente specifike për personat me aftësi të kufizuara, e cila do të jetë dokumenti i parë dhe më i rëndësishëm që do të afirmojë dhe mbrojtë të drejtat e kësaj kategorie. Për vite me radhë OJF-të që veprojnë në fushën e AK dhe antarët e Kombeve të Bashkuara kanë diskutuar mundësinë e hartimit të një konvente specifike për PAK. Fillimisht këto iniciativa ishin kundështuar me justifikimin se ekzistenca e instrumentave të të drejtave të njeriut ofron një mbrojtje të mjaftueshme. Por pavarësisht nga kjo, mbështetja për hartimin e një kon-

vente specifike është një ide që është rritur në vazhdim dhe me një ndikim të veçantë të lëvizjes të organizatave që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar.

Kjo ide është zhvilluar që prej muajit Prill 2000 ku Komisioni i UN për të drejtat e njeriut me rezolutën 2000/51, ftoi Komisionerin e Lartë për të drejtat e Njeriut për të ekzaminuar masat për forcimin e mbrojtjes dhe monitorimin e të drejtave të njeriut në këndvështrimin e aftësisë të kufizuar. Më pas në Nëntor 2001, Presidenti Meksikan bëri një fjalim në Asamblenë e Përgjithshme të UN duke prezantuar idenë e një konvente. Ai tha "do të ishte e pamundur ta bëje këtë botë më të mirë në rast se ne lejojmë përjashtimin e grupeve më





vulnerable”. Duke konkluduar në Dhjetor 2001 ku Asambleja e Përgjithshme krijoi Komitetin Ad Hoc për hartimin e një Konvente ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe dinjitetit të PAK. Kjo draft-konventë do të bazohet në fushën e zhvillimit social, të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimit, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Komisionit për të drejtave të njeriut dhe Komisionit për zhvillim Social. Në Korrik – Gusht të vitit 2002: Komiteti Ad Hoc mbajti takimin e tij të parë i cili u fokusua në strukturën e konventës të propozuar dhe proceset për zhvillimin e saj. Ky komision mbledhet 2 herë në vit. Ndërsa grupi i punës është i përbërë nga përfaqësues të qeverive antare të UN, organizata jo qeveritare dhe institucione kombëtare të të drejtave të njeriut.

Në 2.08.2005 — 12.08.2005

u mbajt sesi i 6-të i Komitetit Ad Hoc në të drejtat dhe dinjitetin e PAK. Në muajin Gusht 2004, për herë të parë, u bë e mundur edhe pjesmarja e Shqipërisë, në një

Përse duhet kjo konventë?

- Kjo konventë ka potencialin për të bërë një konventë specifike me norma ligjore për të mbrojtur të drejtat e PAK.
- Shpresohet se ky dokument do të përmirësojë profilin dhe statusin e PAK në mbarë botën duke modernizuar të drejtat e PAK dhe mbrojtjen më të mirë të tyre.
- Kjo konventë mund të zhvillojë politikat sociale dhe të krijojë referenca të qarta për të ardhmen për zhvillimin e të drejtave të PAK.
- Eksperiencia jetësore e deritanishme e PAK ka dëshmuar faktin se të drejtat e PAK nuk kanë qënë të mbrojtura dhe instrumentat ligjore nuk kanë qënë efektivë në adresimin e kësaj situate.

nga sesionet që dikutohej për këtë draf konventë dhe kjo falë ndërhyrjes të Grupit të Avokatisë pranë ADRF. Pasi bëri të mundur realizimin e një takimi me zv. Ministrin e jashtëm, të kohës, z. Luan Hajdaraga, ADRF mori nismën për përfshirjen edhe të shtetit Shqiptar në hartimin e kësaj draft konvente. Deri tashmë kjo konventë është e përbërë nga 25 nene, të cilat janë ende në proces diskutimi nga shtete antare.

KJO KONVENTË KA SI QËLLIM SIGURIMIN E PLOTË, EFEKTIV DHE TË BARABARTË TË GËZIMIT TË TË GJITHË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE TË PAK.

NENI 1	QËLLIMI
NENI 2	PARIMET THEMELORE
NENI 3	PËRKUFIZIMET
NENI 4	DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË SHTETEVE ANTARE
NENI 5	PËRKRAHJA E SJELLJEVE POSITIVE NDAJ PAK
NENI 6	MBLEDHJA E STATISTIKAVE DHE TË DHËNAVE
NENI 7	BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI
NENI 8	E DREJTA PËR TË JETUAR
NENI 9	BARAZIA E TË GJITHË PAK PARA LIGJ
NENI 10	E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI
NENI 11	LIRIA NGA TORTURAT APO NDËSHKIMET, TRJATIMET APO DËNIMET ANTINJERËZORE DHE DEGRADUESE
NENI 12	LIRIA NGA DHUNA DHE ABUZIMI
NENI 13	LIRIA E SHPREHJES DHE E MENDIMIT DHE E DREJTA PËR INFORMIM
NENI 14	E DREJTA PËR INTIMITET, PËR BANIM DHE FAMILJE
NENI 15	JETESA E PAVARUR DHE TË QËNIT I PËRFSHIRË NË KOMUNITET
NENI 16	FËMIJËT ME AFËTËSI TË KUFIZUAR
NENI 17	ARSIMIMI
NENI 18	PJESMARRJA NË JETËN POLITIKE DHE PUBLIKE
NENI 19	PËRSHATSHMËRIA
NENI 20	E DREJTA E LËVIZJES LIRISHT
NENI 21	E DREJTA PËR KUJDES MJEKSOR DHE SHËRBIME REABILITUESE
NENI 22	E DREJTA PËR PUNË
NENI 23	SIGURIMI SHOQËROR DHE STANDARTET E MJAFTUESHME PËR JETESË
NENI 24	PJESMARRJA NË JETËN KULTURORE, KREATIVE, SPORTIVE E KOHËN E LIRË
NENI 25	MONITORIMI, RRJETI NDËRKOMBËTAR I ZBATIMIT TË KËSAJ KONVENTE

PËR AFTËSINË E KUFIZUAR MENDORE DORA E SHTETIT NUK EKZISTON

SFIDA 19

FSDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUAR

E shtë e vështirë të thua sh nëse është bërë mjaftueshëm për t'ua lehtësuar vuajtjet personave me aftësi të kufizuara në vendin tonë. Nevojat janë të përditshme dhe përkujdesja duhet të jetë shumë më e madhe. Këtë gjë e pohojnë të gjithë njerëzit e veshur me pushtet. Shteti me sa duket ka filluar të ndërgjegjësohet. Por ka ende shumë për të bërë, konkretisht. I këtij mendimi është edhe zëvendësudrejtori i Shërbimit Social Shtetëror në Tiranë, Gëzim Tushi. Shteti i ka ndarë këta persona në kategori dhe në statuse të veçanta përfitimi. Ligjet janë shumë strikte, për njerëzit që kanë më tepër nevojë për përkrahje. E kështu statusin e veçantë e përfitojnë të verbërit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, invalidët e punës, sipas grupeve të caktuara. Njerëzit me aftësi të kufizuar mendore kanë mbetur të pambrojtur nga ndonjë status special. Edhe në Shërbimin Social Shtetëror nuk dinë të thonë më shumë për këtë gjë.

Është kategoria më pak e përkrahur.

Aktualisht ata mbrohen vetëm me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për Ndihmë dhe Shërbime Shoqërore", ku flitet për mbrojtje kryesisht përsa i përket kujdesit shëndetësor dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm, apo edhe për sigurimin nga ana e shtetit të mbështetjes financiare dhe materiale. Përveç këtij ligji, nuk ka asnjë status dhe nuk ka ligje më të detajuara për mbrojtjen e tyre. Nuk ka madje as shifra të sakta, ashtu siç është e vështirë të thuash se sa njerëz me aftësi të kufizuara janë realisht në vendin tonë. është një hall i paparashikueshëm, është një fatkeqësi që nuk mund të parandalohet kollaj, me një fjalë goje. Prandaj çdo ditë para shkallëve të Shërbimit Social Shtetëror në Tiranë gjen njerëz që ankohen për diçka, që pyesin dhe nuk dinë ku të drejtohen, që kërkojnë ndihmë ekonomike, apo edhe ligjore. Realisht, në politikat

e shtetit për trajtimin e njerëzve në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, numërohen në rreth 56 mijë vetë. "48 mijë janë personat që përfitojnë nga statutet e tyre. Në grupin e parë hyjnë ata persona që kanë lindur të tillë dhe trajtohen në qendrat tona të zhvillimit. Përgjithësisht ata janë fëmijë të moshës minorene. Pastaj janë të verbërit, paraplegjikët, tetraplegjikët dhe invalidët e punës. Këta të fundit pas një vendimi të qeverisë marrin përveç pagesës nga statusi i invalidit marrin një shtesë pensioni, që quhet asistencë e plotë ose e pjesshme. Përveç 56 mijë personave me aftësi të kufizuar që trajtohen nga buxheti i shtetit, janë edhe 32 mijë invalidë që marrin këtë asistencë sipas shkallës së invaliditetit", shpjegon Gëzim Tushi.

SA PAK KUJDESTARË

Sipas zëvendësudrejtorit Tushi, nga 56 mijë vetë që përfitojnë një pagesë prej 6 800 lekësh në muaj, vetëm 8 mijë janë kujdestarë. A duhet të ketë secili prej tyre apo jo një kujdestar është një çështje që e përcakton vetëm komisioni i vlerësimit të shkallës së paaftësisë. Sipas gjykimit të komisionit mund t'u vendoset edhe kujdestar, që paguhet me të njëjtën masë, pra 6 800 lekë në muaj, për t'i shërbyer një personi që ka

nevojë për një shërbim special. “Kujdestarët caktohen zakonisht për një të verbër që ka nevojë të shoqërohet kudo, apo për një person tetraplegjik, që ka nevojë për kujdesjen e një njeriu tjetër. Kujdestari, deri tani, është një nga pjesëtarët e familjes”, thekson Tushi. Sipas tij, pagesa e paaftësisë është individuale. Atë e përfitojnë të gjithë ata që kanë nevojë, pavarësisht nëse janë të varfër, apo të pasur, pavarësisht nëse kanë pjesëtarë të tjerë të familjes të punësuar, apo jo. “Skema që trajton këta persona me aftësi të kufizuara është buxhetore. Ata trajtohen pa asnjë lloj kondicionimi dhe nuk ka të bëjë nëse është i varfër, i pasur, i një përkatësie rajonale, krahinore, politike, mjafton që të ketë statusin dhe ai trajtohet në mënyrë automatike”, deklaroi ai. Nga pikëpamja e buxhetimit, sasia e parave me të cilat trajtohen 56 mijë persona me aftësi të kufizuara është shumë më e madhe se sa masa totale e ndihmës ekonomike që përfitojnë familjet e varfëra në vend. Megjithatë përmirësimet, ende nuk ka gjetur zbatim ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, apo edhe zgjidhjet alternative nëpër trotuare dhe pallate që duhet të jenë të përshtatshme për lëvizjen e këtyre personave. Nëndrejtori gjithësesi shprehet optimist. “Fillesat tregojnë se ka sensibilitet nga ana e shoqërisë. Ata nuk mund të integrohen,

nëse nuk i fusim në shoqëri. Nëse ne si shoqëri nuk u zbulojmë aftësitë që ata kanë atëherë do të thotë që politikën që ne zbatojmë janë pjesë e propagandës së zakonshme që nuk u sjell atë kënaqësi që ata shpresojnë prej shoqërisë”, pohon Tushi.

TË BREDHËSH NËPËR KOMISIONE

Hallkat e përcaktimit të paaftësisë janë të ndara. Një nga këto është përcaktimi mjekësor i aftësisë së kufizuar. Kjo është edhe faza më torturose për njerëzit me aftësi të kufizuara, të cilët duhet të paraqiten çdo vit përpara një komisioni që duhet t’u caktojë shkallën e aftësisë së kufizuar, shkallën e verbërisë, etj. “Çdo të premte në këtë institucion komisionohen për herë të parë ose rikomisionohen personat me statusin e të verbërit”, shpjegon Tushi. Dhe kështu vazhdojnë për vit. Duke plotësuar dosje me dokumenta, duke u ekzaminuar dhe riekzaminuar nga mjekët, specialistët dhe ekspertët e fushave të paaftësisë. Për njerëzit me halle dhe probleme kjo gjë është e tepërt, gjithmonë kushton dhe është shumë e lodhshme. Ata duhet të vijnë nga rrethet ku jetojnë në Tiranë, duhet të marrin vula dhe certifikata. Mjekët e motivojnë këtë gjë me faktin se gjendja shëndetësore e tyre mund të ndryshojë dhe për këtë duhet të bëhet diagnostikimi i vazh-

dueshëm. Nëndrejtori i Shërbimit Social Shtetëror pranon se kjo është vetëm pjesa pasive e skemës. Këta persona kanë nevojë të rehabilitohen, dhe këtë proces ai e konsideron akoma më i vështirë. “Fëmijët që kanë lindur të tillë trajtohen në qendra nga specialistë për të arritur aftësimin e munguar të tyre fëmijëve. Në krahasim me të kaluarën, dua të theksoj se sot ka një vëmendje shumë herë më të madhe ndaj këtyre qendrave”, thotë Tushi. Shteti, sipas tij, ka ndryshuar politikën e punës. Nëse deri disa vite më parë politikën për personat me aftësi të kufizuar kanë qenë monopol i shtetit dhe nëse skemat kanë qenë tërësisht në duart e tij, ka ndodhur një proces shumë i rëndësishëm ndryshimi. “Personat me aftësi të kufizuar janë lobuar janë organizuar, kanë filluar të kenë përfytyrim të saktë për statusin e tyre, janë më koshientë për të drejtat e tyre dhe dinë shumë mirë t’i kërkojnë ato”, shpjegon nëndrejtori.

A KA ABUZIME ME SKEMËN?

A e përfitojnë realisht personat me aftësi të kufizuar pagesën që u takon, apo ka abuzime në skemën që zbaton Shërbimi Social Shtetëror? Kësaj pyetjeje nëndrejtori nuk di si t’i përgjigjet. Abuzime, sipas tij, është shumë e vështirë që të ekzistojnë. “Nuk e di se si mund

të ketë abuzime në këtë skemë, sepse praktikisht është një komision që përcakton shkallën e aftësisë së kufizuar. Ky komision dokumentet i dërgon në pushtetin vendor, i cili i kalon në Shërbimin Social Shtetëror. Në përputhje me këto vlerësime ne bëjmë shpërndarjen e fondëve të buxhetit të shtetit për pushtetin vendor dhe këto pagesa bëhen në pushtetin vendore dhe janë personale. Pra nuk mund që një person që ka statusin e personit me aftësi të kufizuara të mos i jepet pagesa është e pamundur dhe nuk është e mundur që pagesa e tij të merret nga një tjetër”, thotë ai. Gëzim Tushi e cilëson të drejtë nevojën për rritjen e pagesës së paaftësisë. “Ata kërkojnë që kjo masë e pagesës të rritet dhe kjo është e drejtë. Mirëpo pagesa është gjithmonë në raport me pagën minimale të një shteti dhe në kushtet e vendit tonë, paga minimale e një punonjësi është 10 800 lekë. Në çdo shtet modern social, këto pagesa janë të lidhura gjithmonë me përshkallëzimin e rritjes së pagës minimale. Nëse kjo rritet atëherë edhe pagesa e tyre do të rritet”, thekson Tushi. Por ajo që kanë më shumë nevojë këta persona është mbështetja dhe integrimi në shoqëri, nëpërmjet programeve komunitare. “Ata kanë nevojë për struktura sociale, sepse ata nuk kanë nevojë vetëm të vishen, të ushqehen, të kenë televizor, të kenë pak kar-

burant për të bërë një shëtitje të ligjshme, ata kanë nevojë për integrim, kanë nevojë ta gjejnë veten të përfshirë. prandaj duhet të hartohen politikat aktive të këta persona. duhen më shumë qendra ditore dhe vende takimesh, argëtimi dhe lobimi, qendra komunitare për të ngritur zëri dhe të diskutojnë në mënyrë që të sigurohet një gjithëpërfshirje e tyre në jetën komunitare”, pohon ai.

PROJEKTI I BANKËS BOTËRORE

“Në vitin 1999 ne jemi inkuadruar në një projekt të Bankës Botërore, që po zbatohet si projekt pilot në Tiranë Durrës Shkodër dhe Vlorë. thelbi i tij është decentralizimi i shërbimeve sociale, dhe të shpërndahen në komunitet. Jo t’i marrim ata dhe t’i çojmë ku janë rezidencat, por shërbimin ta ofrojmë atje ku janë ata persona me aftësi të kufizuar. Ndryshimi i këtij kahu sigurisht që është shumë i vështirë dhe ne duam që të ngrihen qendra të tilla, për të cilat duhet të ketë përgjegjësi pushteti vendor. Rezidencat nuk i shpëtojnë dot karakterit të “burgut social”, sepse njerëzit nuk duhen shpëputur nga ambineti natyror. Një gjë është e rëndësishme, që vetëm në mënyrë natyrore mund të integrohet njeriu dhe vetëm duke qenë pranë njerëzve këto vështirësi mund të zbuten”, thotë Gëzim Tushi.

FONDACIONI

“Fondacioni Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është një nga fondacionet më të rëndësishme në këtë fushë. Kemi vënë re që ka filluar të zgjerohet trajtimi i këtyre personave nga organizatat joqeveritare. Kjo shoqatë ka aftësitë më elokumente në këtë fushë është më e njohura, sepse përveç se është qendër trajtimi dhe këshillimi, madje edhe juridik, jo vetëm që është bërë avokate legjitime, por ka filluar të prodhojë edhe objekte dhe sende të ndryshme që i ndihmojnë këta njerëz”, thotë Gëzim Tushi.

PROGRAMI PËR SHKOLLËN E LARTË

Nevoja për specialistë të fushës së aftësisë së kufizuar e ka bërë të domosdoshme hapjen e kurseve të veçanta të trajnimit të tyre. Kështu, për herë të parë në bashkëpunim me qeverinë zviceriane dhe me fondacionin ASED, është hapur në Universitetin e Vlorës, dega e pedagogjisë së specializuar. Këtë vit do të dalë edhe kursi i parë i specialistëve, që janë përgatitur nga pedagogë të huaj të specializuar në fushën e personave me aftësi të kufizuara. Pranë universitetit është edhe qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar i cili është një “laborator” për aplikimin e njohurive që merren nga pedagogët e shquar.

Brikena Demiras
Gazeta “Panorama”

Krahas materialeve të za konëshme, të domos doshme për një proces votimi, në qendrat e votimit për Zgjedhjet për deputetë në Kuvendit të Shqipërisë të 3 Korrikut 2005, votuesit vunë re se në mjediset e votimit, krahas dhomave të fshehta të zakonëshme ishin edhe disa të tjera me dimensione të ndryshme nga të parat; mbi tryezat e komisioneve u shfaqën gjithashtu edhe disa zarfe të vecantë, që kishin dimensione dhe ngjyrë të njëjtë me fletët e votimit. Për herë të parë në historinë e proceseve zgjedhore në Shqipëri, në zgjedhjet e 3 Korrikut 2005, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mundi të realizojë dhe të shpërndajë në qendrat e votimit mjetet e posaçme të votimit për të verbërit si dhe dhomat e fshehta të përshtatura për përdoruesit e karrigeve me rrota, duke krijuar kështu më shumë akses për votim të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për të gjithë qytetarët.

Në vitin 2002, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, nisi përpjekjet e organizuara, të parat e këtij lloji në periudhën pas '90, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të përfrshiheshin tërësisht në proceset zgjedhore, që edhe e drejta kushtetuese e votës të realizohej e barabartë, e drejtpërdrejtë dhe e fshehtë edhe për zgjedhësit me aftësi të kufizuar - të verbër, me probleme të lëvizjes dhe të hospitalizuar dhe me pamundësi për të lëvizur nga shtëpia, e drejtë të cilën praktikisht nuk e ushtronin dot.

Ketij qëllimi i ka sherbyer edhe fushata për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore, pjesë e të



E drejta kushtetuese e përfshirjes në proceset zgjedhore - e drejtë e barabartë për të gjithë qytetarët

ciles ishte edhe organizimi i misionit të vëzhgimit të procesit të votimit për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, 3 Korrik 2005.

Në këtë mision vëzhgimi u përfshinë 66 vëzhgues vendore, të gjithë persona me aftësi të kufizuar dhe familjare të tyre, të cilët vëzhguan 142 qendra votimi, në tri qytete – Tirane, Elbasan dhe Librazhd.

Monitorimi i procesit të zgjedhor nga grupi i vëzhguesve me aftësi të kufizuar pati për qëllim vëzhgimin e aksesit të krijuar dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në votimet e 3 Korrik 2005, duke evidencuar respektimin e të drejtës

për të votuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, të lirë e demokratike, si të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Shqipërisë.

Për të evidencuar shkallën e përfshirjes së Personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore, përcaktimi i procesit të vëzhgimit që u zhvillua në ditën e votimeve, 3 Korrik 2005, u realizuan edhe sondazhe para zgjedhore, ditën e votimeve dhe pas zgjedhore, nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta, intervistave telefonike dhe pyetësoreve të posaçme.

Si rezultat i përpjekjeve të bëra nga FSHDPK dhe organizatat e aftësive të kufizuar, anetare të



Grupit të Avokatise, u arriten permiresime ne Kodin Zgjedhor drejt garantimit te te drejtes per te votuar per personat me aftesi te kufizuar, vecanerisht per personat e verber me ane te mjeteve te posaçme. Megjithate, neni 103 i Kodit Zgjedhor ka ende mangesi, te cilat ndikojne ne uljen e % se PAK ne votime, mangesi qe kane te bejne me mungesen e alternativave bashkekohore per zgjedhesit me aftesi te kufizuar fizike si dhe mungesen e nje mekanizmi qe ben te mundur identifikimin e zgjedhesve me aftesi te kufizuar.

Çfare ofroi sistemi administrativ zgjedhor?

Per here te pare ne historikun e proceseve zgjedhore ne Shqiperi u mundesua realizimi i votimit te drejtperdrejte dhe te fshehte per te verberit ne Shqiperi permes mjeteve te posaçme te votimit.

U ofrua nje akses i pjeseshem per personat me aftesi te kufizuar fizike dhe te moshuarit. Kjo u pasqyrue ne vendosjen e qendrave te votimit kryesisht ne katet per dhe te ndertesave si edhe ne ofrim pershtatshmerie brenda qendrave te votimit, duke patur nje nivel me te larte te njohjes se problematikes nga komisioneret si dhe u pergatiten dhe u shperndane nga KQZ dhoma te fshehta votimi, te posaçme per perdorim nga PAK, perdorues te karrigje me rrota.

Për herë të parë në historinë e proceseve zgjedhore në Shqipëri, në zgjedhjet e 3 Korrikut 2005, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mundi të realizojë dhe të shpërndajë në qendrat e votimit mjetet e posaçme të votimit për të verbërit si dhe dhomat e fshehta të përshtatura për përdoruesit e karrigjeve me rrota, duke krijuar kështu më shumë akses për votim të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për të gjithë qytetarët.

Si rezultat i pamjaftueshmërisë së koordinimit nga strukturat zgjedhore, nuk u arrit identifikimi i PAK ne listat e votimit, gje qe do te çonte ne ofrimin



SFIDA 19

FSDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PER TE DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR

e me shume akses per ta, per te realizuar pjesemarrje me te gjere ne votime. Nuk pati nje angazhim serioz te strukturave perkatese per te realizuar pershtatshmeri me te gjere per pjesemarrje ne votime te PAK (edhe pse qendrat e votimit ishin ne katet per dhe te ndertesave, ato kishin shkalle ne hyrje). Nuk u mundesua edhe ngritja e qendrave te posaçme te votimit per zgjedhesit e hospitalizuar.

Eshte e rendesishme te theksohet qe procesi i perfshirjes se PAK ne proceset zgjedhore ka njohur progres brenda nje periudhe kohore te shkurter. Ne Shqiperi ka nje klime positive per te respektuar te drejten e votes edhe per zgjedhesit me aftesi te kufizuar. Edhe pse ka arritje pozitive ne drejtim te permiresimit te legjislacionit dhe te zbatimit te tij, realizimi i pjesemarrjes se plote te PAK ne proceset zgjedhore kerkon angazhime te metejshme, per te arritur standartet, per te realizuar ate qe edhe nje zgjedhes i vetem me aftesi te kufizuar te mos mbetet pa votuar.



Ndërtimi pa barriera dhe specialistët

Kohët e fundit është rritur mjaft informacioni mbi konceptet e reja në projektim e në ndërtim e në këtë kuadër edhe ndjeshmëria e institucioneve, në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, mbështetur në një kontribut të jashtëzakonshëm të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Reflektimi i drejtpërdrejtë i kujdesit për integrimin në jetën shoqërore e politike të vendit, të personave me aftësi të kufizuara, është krijimi i infrastrukturës mbështetëse e veçanërisht eliminimi i barrier-

ave gjatë projektimit e zbatimit të objekteve.

Miratimi nga Këshilli i Ministrave, në Qershor 2004, i Rregullave Urbanistike e Arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara, në formën e një detyrimi ligjor për projektuesit, investitorët e zbatuesit, ka rritur shkallën e ndërgjegjësimi dhe përgjegjshmërisë për specialistët e fushës.

Rritjes së nivelit të ndërgjegjësimi i kanë shërbyer edhe trajnimet që Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka zhvilluar me drejtuesit dhe specialistët e planifikimit urban

dhe sekretarisë së KRRT-së në bashkitë dhe qarqet kryesore të Shqipërisë

Keto trajnime janë zhvilluar ar tashme në qytetin e Tiranës, Durrësit, Vlores, Elbasanit, Pogradecit, Shkodrës e Lezhës. Në to kanë marrë pjesë rreth 75 persona, të cilat përfaqësojnë filtrat e projektimit e të zbatimit të projekteve të arkitekturës, urbanistikës e të infrastruktures. Gjate zhvillimit të trajnimeve, në përgjithësi është vënë re një predispozicion i plotë e vullnet i mirë, për të vënë në zbatim rregullat e miratuara.

Nga diskutimet e pjesëmarrësve fitohet një informacion që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përballur individualisht me problemet dhe vështirësitë me të cilat bashkëjetojnë personat me aftësi të kufizuara, mbasi jetojnë shumë pranë tyre, si fëmijë, prind, motër e vëlla ose të afërm të tjerë.

Është theksuar që të gjithë specialistet duhet të ndjehen debitorë ndaj personave me aftësi të kufizuara në lidhje me atë që mund të bëjnë, pa u kritikuar nga askush, përveç disa ndërtuesve dhe investitorëve që kanë përcaktuar norma shumë të larta fitimi për bizneset e tyre, pa marrë parasysh që komoditeti është i cunguar në rast se nuk është i përshtatshëm për të gjithë.

Askush nuk do të kritikohej në rast se do të projektonte e ndërtonte pa barriera duke krijuar mundësi që të gjithë objektet e mjediset e jetesës, punës, të studimit e të argëtimit

të ishin të përshtatëshme e të arritëshme nga të gjithë.

Duke gjykuar në këtë mënyrë i bëhet një shërbim jo vetëm personave me aftësi të kufizuar, por të gjithë shoqërisë, duke mundësuar përfitimin e resurseve që kanë të fshehura këta persona e që për shkak të barrierave që krijohen nga projektuesit e ndërtuesit, shoqëria nuk arrin t'i përfitojë.

Duke gjykuar në këtë mënyrë, njëkohësisht i shërbehet vetvetes, mbasi secili mund të ketë një periudhë të jetës së tij me aftësi të kufizuar, për shkak të moshës, të një sëmundje etj.

Ritmet e larta të ndërtimit, veçanërisht në qytetet kryesore dhe rritja e cilësisë së tyre, me përdorimin e materialeve të kushtueshme, janë ende në kontradiktë me komoditetin e brëndëshëm, që jep hapësirat e nevojshme dhe elementi mbështetës, që përveç se është estetik, është edhe funksional.

Duke u nisur nga përvoja e tyre si projektues dhe ndërtues, specialistet evidentuan se të ndërtosh me projekt funksional, është më lirë se të rikonstruktosh për të përmirësuar funksionet, gjë që bëhet më e vështirë për hapësirat e ashensorëve, shkallëve e në shumë raste të tualeteve, dyerve etj.

Gjatë ketyre trajnimeve, është vënë re se shtojca e rregullores së urbanistikës, do të superojë mungesën e deritanishme të vëmëndjes së këtyre strukturave përgjegjëse, ndaj personave me aftësi të kufizuar.

Jane për t'u pershëndetur iniciativat, ndonese te shkepultura në disa qytete, te prezantuara gjate trajnimeve, për të aplikuar në ndonjë mjedis ose

trotuar, të detajeve të pasqyruara në "Shtojcën e Rregullores së Urbanistikës".

Eshte për t'u vlerësuar angazhimi i menjehershëm i bashkise se Tiranes, qe u evidentua edhe gjate trajnimit, qe vendosi barrierat për miratimin e projekteve qe nuk hartohen ne pershtatje me Rregullat Urbanistike dhe Arkitektonike për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Por nga ana tjetër është fare i pakuptimte vendimi i KRT-se një bashkie që quan të parakohshëm zbatimin e ketyre Normave në vendin tone.

Një përvojë shumë interesante u prezantua për pjesëmarrësit, nga përgjegjësi i zyrës së urbanistikës në Koplik, i cili kishte kaluar disa ditë në Pekin dhe kishte vënë re se të gjithë hotelet e rinj me 5 yje, nuk kishin shkallë në hyrje, por vetëm plane të pjerrët.

Një eksperiencë e tillë tregon se kur grupi ndërtues, projektuesi, investitori, dhe ndërtuesi, kanë vision dhe duan të realizojnë vepra të qëndrueshme, nuk kalojnë nëpër të gjitha etapat që ka kaluar shoqëria njerëzore, nga diskriminimi i personave me aftësi të kufizuar deri tek in-

SFIDA 19



tegrimi i tyre, por kalojnë direkt, në konceptin më të përparuar që po përpunohet sot në botën e zhvilluar, në konceptin e gjithëpërfshirjes

Vazhdon të jete në proces zhvillimi i trajnimeve në qarqe e bashki të tjera të vendit. Por duhet theksuar se është momenti që krahas fushatave ndergjegjesuese, të kerkohet aplikimi masiv i rregullave të Urbanistikës e të Arkitekturës, për Personat me Aftësi të Kufizuar, si detyrim ligjor, ndaj shkeljes se te cilit te mbahet i njejt qendrim si për çdo shkelje tjetër ligjore.

Duke pranuar që shoqëria ecen gjithnjë drejt progresit, duke besuar në rritjen e vazhdueshme të aftësisë profesionale dhe përgjegjshmërisë së specialistëve, të cilët përqafojnë çdo gjë të re e progresive, aplikimi i koncepteve të reja në ndërtim, përfshi edhe *ndërtimin pa barriera ose ndërtimin për të gjithë*, do të jetë shumë shpejt pjesë e të gjitha studimeve dhe aplikimeve në fushën e ndërtimit.



Indrit Hazizolli , i mituri elbasanas qe u ben thirrje mjekeve ta shpetojne nga karrikja me rrota

Nje nder 200 personat me aftesi te kufizuara qe numeron rrethi i Elbasanit ehte edhe i mituri Indrit Hazizolli banues ne fshatin Katund i Ri te komunes se Bradasheshit. Ai prej pese vitesh per shkak te nje semundjeje ka perfunduar ne karrocen e invalidit. Megjithe ngrohjetesine e pazakonte prinderore dhe te gjitha te afermeve Indriti 14- vjeçar ndjehet teper i trishtuar per te ardhmen. Kerkon qe te mos privohet nga e drejta per tu kuruar ne nje klinike te specializuar jashte shtetit per ti rikthyer jetes normale, sepse ne Shqiperi kjo eshte e pamundur. Por deri tani te gjitha tentativat e familjes Hazizolli per

te siguruar nje vize ne ambasadat e shteteve perendimore ne Tirane kane deshtuar. Ministria e Shendetesise dhe te gjitha institucionet e tjera shtetore si çdo hallexhiu tjeter edhe ne kete rast i kane kthyer shpinen.

SEMUNDJA

Afro pese vite me pare kur Indrit Hazizolli ndiqte mesimet ne klasen e trete ne sh-

kollen e fshatit Katund i Ri eshte prekur nga semundja e distrofise muskulare. Kjo fillimisht nuk eshte zbuluar as nga mjeket tek te cilet prinderit e kishin derguar per kontroll me njehere pasi ai kishte shfaqur probleme me shendetin. Keto kontrolle kane qene te shpeshta dhe te vazhdueshme dhe mjekimet qe i jepnin mjeket nuk kish-



in efektin qe pritej. Prinderit jane perpjekur qe ta dergojne te specialiste me ze te kesaj fushe te mjekesise. Te gjitha na jepnin shprese se shendeti i djalit do te permiresohej por ndodhi e kunderta thone prinderit e tij. Per shkak te semundjes Indriti u detyrua te bente mungesa te shumta ne shkolle deri ne shkeputjen e detyrueshme nga ajo. Dëshira e madhe per te ndjekur mesimet dhe rendimi i semundjes jane bere nje torture per jeten e tij. Ai ndjehet mjaft keq tani qe e di se semundja e tij mund te kurohet jashte shtetit dhe se ne Shqiperi shanset jane te pakta.

KARROCA

Ajo qe ai e urrente me shume ishte karroca e invalidit dhe mjerisht tani ajo eshte bere pjese e jetes dhe e trupit te tij. Qe prej disa muajsh 14-vjeçari Indrit Hazizolli qendron dhe leviz ne karrocen e invalidit. Pamundesite per te levizur duart dhe kembet por edhe trupin e kane detyruar kete te mitur qe ta pranoje karriken me rrota, pjese te jetes se perditshme te tij. Me te prinderit dhe te afermit e levizin ne lagjen ku ai jeton. Indriti kerkon qe te shkoje te shoket e tij te shkolles dhe te shkolla e tij edhe pse nuk mundet. Por edhe shoket kur kane kohe i shkojne ne shtepi, i bejne shoqeri, i tregojne per mesimet, madje perpiqen qe dhe te luajne dhe ta argetojne. Shpresoj qe te sherohem dhe te shkoj serish ne shkolle sepse shkollen e kisha filluar me shume qejf. U kisha premtuar prinderve se do te isha nxenes i shkelqyer por se-

mundja ma la kete enderr ne mes, vetem pak sikur te permiresohem do te kerkoj qe te ndjek shkollen. Nuk dua qe te dorezohem kurre perpara te keqes.

PRINDERIT

Prinderit Gezim dhe Mimoza Hazizolli e kane brenge te madhe fatkeqesine qe ka prekur djalin e tyre te dyte dhe nuk po lene gure pa levizur per ti gjetur derman te birit. Nga mjeku ne mjek dhe nga spitali ne spital. Shpresonim se ne spitalin ushtarak do te gjenim shpetim por as aty nuk qe e thene te behej dicka. Çifti Hazizolli tani i ka shpresat vetem te mjeket e huaj. Po bejme te gjitha pre-pjekjet por pak kush na gjen-det ne krah thone prinderit e 14-vjeçarit Hazizolli fatkeqesite na kane goditur njera pas tjetres. Pak vite me pare na prishen shtepine sepse e kishim ndertuar pa leje pak me larg kesaj ku banojme tani. Na ka ndihmuar shume komuna e cila me propozim te kryetarit te saj sabri sollaku na vuri ne dispozicion truallin ndersa te afermit na ndihmuan financiarisht per ndertimin e baneses. Kjo sikur na e ka zbutur disi semundjen e djalit. Punoj nate e dite per tu siguruar atyre kushte sa me te mira shprehet Gezim Hazizolli. Bej çdo lloj pune vetem e vetem qe te nxjerr sa me shume para per familjen. Mirepo jo gjithmone ka pune dhe as njerezit nuk kane para per te paguar aq sa duhet.

FAMILJA

Familja Hazizolli perbehet nga 6 anetare ku me i madhi i femijeve eshte Maringleni 17 vjeç ndersa me te vegjlit

SFIDA 19



jane Klodiani 11 vjeç dhe Daniela 3 vjeçe. Ne pjesen me te madhe te kohes vellezerit dhe motra e Indritit i qendrojne prane atij duke mos e lene ate ta ndeje semundjen. Ata perpiqen ti kr-ijojne te gjitha kushtet per te cilat ai ka nevojte. Mirepo bar-ra me e rende ne kete familje u ka rene prinderve te Indritit. Ata nga mengjesi deri ne mbremje i luten zotit per shpetimin e tij nga semundja.

APELI

I mituri qe vuan nga dis-trofia muskulare perpiket qe ta harroje semundjen qe e ka ulur ne karrocen e invalidit. Ai ka disa kohe qe po u drej-tohet autoriteteve shteterore qe te mos bejne shurdhme-mecin por ta ndihmojne per tu kuruar jashte shtetit. Do tjua shperblej te gjitha aty-re qe do me ndihmojne shprehet 14 vjeçari nga Ka-tundi i Ri. Semundja po me rendohet dhe nuk du te mbe-tem keshtu e te jem barre per familjen. Nese nuk me ndih-mon shteti pres edhe nga ndoje shoqate. Deri tani vet-em shoqata e paratetraple-gjikeve po kerkon te gjeje ndoje mundesi per ta derguar jashte shtetit Indritin. Por nuk mjafton vetem kaq. IN-DRITI eshte vetem 14 vjeç dhe kerkon te jetoje si gjitha te tjeret. Nje trajtim i se-mundjes se tij jashte shtetit shihet si shprese per sherimin e sigurte te tij.

Fatmir Popja/Elbasan
“Gazeta Shqiptare”

Ne kuadrin e nje programi te mbeshetur nga Soros, Fondacioni i Shoqerise se Hapur per Shqiperine, FSHDPAK, gjate vitit 2005, eshte duke zhvilluar nje aktivitet intensiv, me synim nxitjen e zbatimit te Strategjise Kombetare, permbushjen e qellimit dhe respektimin e parimeve baze qe pershkojne kete kornize politikash te aprovuar ne janar 2005 nga Qeveria Shqiptare, qellim dhe parime qe jane ne perputhje me misionin dhe vizionin e Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te kufizuara.

Mungesa e deritanishme e nje strategjie kombetare te AK ka sjelle si pasoje mungesen e strukturave monitoruese. Vleresimi dhe monitorimi ne fushen e aftesise se kufizuar thuajse ka munguar totalisht. Problematika e aftesise se kufizuar eshte trajtuar dhe rrjedhimisht eshte vleresuar ne menyre fragmentare, nderkohe qe FSHDPAK ne programet e veta promovon idene e barazise se mundesive dhe aksesin ne te gjitha fushat, qe do te thote nderhyrje multi-sektoriale dhe monitorim shu-medimensional.

Për realizimin e kësaj Strategjie kërkohet nga pushteti



PER NJE ROL ME AKTIV TE SHOQERISE CIVILE PER ZBATIMIN E STRATEGJISE KOMBETARE PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR

qëndror, pushteti vendor, OJF-të; vetë personat me aftësi të kufizuar si dhe nga shoqëria në tërësi, të angazhohen në mënyrë aktive për zbatimin e saj.

Nder drejtimet kryesore ku Fondacioni e ka drejtuar aktivitetin e vet per te kontribuar ne nxitjen e zbatimit te SKAK eshte njohja e gjithë aktoreve pergjegjes per implementimin e saj, me permbajtjen e ketij do-

kumenti politik, planin e vepërimit, pergjegjesite respektive ne planifikim, zbatim dhe vleresim.

Nje vemendje e vecante i eshte kushtuar, perfshirjes se organizatve te njerezve me aftesi te kufizuara duke investuar ne krijimin e kapaciteteve te tyre permes dhenies se metodave dhe mjeteve per avokim me synim realizimin e fushatave te avokatese ne nivel qendror dhe lokal, ne funksion te nxitjes se zbatimit te strategjise kombetare te AK, si dhe per te avokuar ne pergjithesi per respektimin e te drejtave te njerezve me aftesi te kufizuara dhe familjareve te tyre ne Shqiperi. Ketij qellimi i kane sherbyer realizimi i 4 senacave te trajnimit me pjesmarrjen e 60 perfaqesuesve nga OJF te fushes se AK, perkatesisht ne Tirane, Shkoder, Elbasan dhe Pogradec.

Permes seminareve njohese & ndergjegjesuese per strategjine kombetare ne nivel rajonal qarku/



prefekturë, bashkie dhe në disa raste minibashkie, me strukturat shtetërore përgjegjëse për problematiken e AK në nivel Qendror dhe lokal, me përfshirjen dhe të organizatave të njerezve me AK është synuar krijimi i një dialogu që do të mbetet i hapur për planifikim, koordinim dhe ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të SKAK.

Jane realizuar tashme seminare në disa rajone si Shkoder, Tirane, Elbasan dhe po punohet për organizimin në vazhdimësi të tyre në rajone të tjera të Shqipërisë si Korçë, Lezhë, Berat etj.

Në seminarin e zhvilluar në qytet e sipërpervendura më së paku 129 persona, përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel drejtor drejtorie dhe specialiste të fushës prane departamenteve përkatëse.

Axhenda e zhvillimit të seminareve është ndërtuar e tillë që në pjesën e parë të seminarit bëhet një prezantim i qëllimit të këtij projekti, një prezantim i shkurtër i SKAK, i rolit që OJF e AK, të grupuara prane FSHDPAK, luajnë në hartimin e saj, i rendet se realizimi i monitorimit dhe i mekanizmave të ndryshme monitoruese të Strategjisë.

Në pjesën e dytë, pjesëmarrësit të ndarë në grupe sipas departamenteve që përfaqësojnë, në përputhje me fushat e veprimave të SKAK, bazuar në materialin ndihmës të përgatitur nga grupi i ekspertëve të FSHDPAK, analizojnë çdo objektiv të fushës të paraqitur në Strategji duke diskutuar dhe duke parashtruar dhe rekomandime për indikatorët që mund të përdoren në funksion të mekanizmit monitorues.

Për të realizuar dialog dhe ndërgjegjësim në një shkallë më të gjërë të të gjithë komunitetit për Strategjinë Kombëtare të AK, për të bërë të qartë rolin dhe përgjegjësitë e të gjithë aktoreve në mënyrë të vecantë rolin e pushtetit qendror dhe lokal, shoqërisë civile por edhe të gjithë komunitetit për të përmbushur objektin

***FSHDPAK, promotore
për hartimin dhe
aprovimin e
Strategjisë Kombëtare
për Personat me
Aftësi të Kufizuara
(SKAK), vazhdon të
luajë rol nismëtar,
tashmë për të nxitur
implementimin e saj.***

vat dhe masat konkrete që realizojnë gjithëpërfshirje dhe trajtim të barabartë në komunitet për të gjithë njerezit me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, po në kuadrin e këtij programi, FSHDPAK ka parashikuar realizimin e dy debateve televizive, njëri prej të cilëve tashmë është realizuar në Qarkun e Elbasanit, përmes televizionit ETV. E veçanta e këtij emisioni sikurse u shprehën dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal të ftuar në emision, por dhe gazetar/moderator i debatit, ishte se për herë të parë në ETV, në këto media lokale, organizohet një debat i tillë krejtësisht i fokusuar në problematiken e aftësisë së kufizuar, përmes diskutimeve rreth Strategjisë Kombëtare të AK. Elbasani si dhe ETV u zgjodh për disa arsye: a) si qytet me % shumë të lartë të njerezve me AK, b) Qytet ku qarku dhe Bashkia janë përgjegjës pozitivisht bashkëpunimit dhe në këto kuader është e nevojshme që të investohet më tej në të gjitha aspektet, qoftë

SFIDA 19

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUAR

dhe atë të informimit për të nxitur më tej sa më konkretisht zhvillimin dhe në fushën e AK, c) qytet që mund të përdoret si model për arritjet në fusha si arsimi i integruar, shërbimet, punësimi etj, për të replikuar dhe në qytete të tjera. Emisioni u përgatit nga kryeredaktori i ETV, i cili ka qenë një ndër gazetarët që në 2 vitet e fundit është përfshirë në programet e FSHDPAK për krijimin e kapaciteteve të mediave kombëtare e lokale për problematiken e AK, dhe u transmetua në një orë të mbremjes me një fluks të konsiderueshëm shikuesish.

FSHDPAK, si organizatë e fokusuar në nxitjen e respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre, do të vazhdojë aktivitetin e vet përmes ndjekjes në vazhdimësi të mënyrës së trajtimit të problematikes së aftësisë së kufizuar, organizimit të platformave për lobim dhe avokim, përdorimit të ekspertizës së FSHDPAK në trajtimin e rasteve të abuzimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njerezve me AK, të gjitha këto në funksion edhe të nxitjes së zbatimit të Strategjisë Kombëtare të AK, si një kornizë e plotë politikash e shtrirë në të gjitha aspektet e jetës ekonomike, politike, sociale dhe kulturore.



Si të gatuajmë receta të reja

Puding me limon

Perberesit per 4 persona:

- 1.50 g gjalpe;
- lengu i dy limoneve;
- lekure limoni e grire;
- 75 g sheqer;
- dy veze te ndara;
- 25 g miell;
- 175 ml qumesht.



Perzjeni gjalpin, sheqerin dhe lekuren e grire te limonit derisa te formohet nje krem. Me pas aty shtoni te kuqet e vezes, miellin dhe lengun e limonit. Perzjejeni ngadale dhe gradualisht shtoni aty edhe qumeshtin. Rrihni te bardhat e vezes derisa te forcohen dhe me pas shtojini tek perberja e limonit. Hidheni kete perberje ne nje ene furre. Me pas kete ene vendoseni ne nje ene tjeter te mbushur deri ne gjysen me uje. Futeni ne furre dhe lereni te piquet per 40 minuta.

Patëllxhanë të mbushur

Për 4-5 persona duhen:

- Patëllxhanë 1 kg,
- qepë 6-7 kokrra ose salcë një lugë gjelle,
- hudhra 2 kokrra,
- kripë,
- piper,
- majdanoz.



Patëllxhanëve u qërohet bishti, u hiqet lëkura në tre rripa sipër dhe nga të dyja anët. Priten për së gjati te pjesa e sipërme deri në mes të tulit. Patëllxhanët vendosen në ujë me kripë për gjysëm ore. Ndërkohë në tigan me yndyrë skuqet qepa e grirë në formë gjysëmrrëthi, shtohen do-

mate të qëruara dhe të prere në copa të vogla; vazhdon kaurdisja në zjarr të avashëm në mënyrë që qepa të zbutet. Në fund shtohen hudhra të grira, majdanoz, kripë, piper dhe pak uthull. Patëllxhanet kullohen, shpëlaken dhe skuqen në tigan me pak yndyrë pastaj rreshtohen në tavë, hapen në vendin e prerë dhe mbushen me masën e përgatitur. Sipër u vihet nga një fetë domate. Shtohet fare pak ujë dhe piquen për një orë në furrë.

Cokollate e nxehë

Perberesit per 1 filxhan:

- 1/2 filxhan kafe e forte e nxehë;
- 1 deri ne 3 luge te vogla sheqer (sipas deshires);
- 1/2 filxhan krem;
- 1 1/2 luge te vogla kakao;
- krem i rrahur;
- 1 luge gjelle cokollate me qumesht e grire;
- nje shkop kanelle.



Ne nje filxhan te madh perzjeni kafen dhe sheqerin. Ne nje tigan te vogel te vene ne zjarr te ulet, ngrohni kremin. Shtoni kakaon dhe perzjejeni mire. Perzjerjen e kremi shtojani kafese. Mbulojeni siper kremin e rrahur dhe cokollaten e grire. Zbukurojeni me nje shkop kanelle.

Sheqerpare

Perberesit per 25 cope:

- Për brumin: Miell 3 gota uji, gjalpë 1 gote, vezë 1 kokërr ose 2 të verdha, sodë një majë luge kafeje,

pak vanilje, sheqer 1 gotë uji.

- Për sherbetin: 2 gota sheqer, një gotë e gjysmë ujë.



Rrihet gjalpi me sheqer, shtohen vezët pjesë-pjesë duke i rrahur vazhdimisht dhe në fund hidhet mielli i perzier me sodë. Zihet brumi i cili pritët ne forma dhe shtrohen në tavë të lyer me gjalpe. Lihet të piquet për 20-25 minuta, hiqet nga furra dhe kur të ftohet i hidhet sherbet i aromatizuar me vanilje.

Tiramisu tradicionale

Perberesit:

- 2 ½ filxhane kafe;
- 10 luge shurup vanilje;
- 4 te verdha veze;
- 3 luge sheqer pluhur;
- 450 g krem pasticerie (panna);
- 4 pako biskota;
- kakao.



Ne nje ene te ceket perzjeje kafen me 2 luge shurup vanilje. Ne nje ene tjeter, rrahim te verdhat e vezeve me sheqerin derisa te marrin ngjyre te zbehte. Shtojme kremin e pasticerise, nga nje luge me rrache, duke e prezjere me kujdes ne menyre qe perberja te jete e lehte. Shtojme pjesen tjeter te shurupit te vaniljes dhe e perzjeje lehte. Lyejme gjysmen e cdo biskote me perberjen e kafese dhe i shtrojmë ne nje tave. Me luge shtrojmë ne pjesen e sipërme te biskotave nje pjesë te perberjes se kremit dhe e sperkatim me kakao.

KURIOZITETE PER JU

- Për të prodhuar 1 kg, mjaltë bletës i duhet të thithë nektarin e 12 milion luleve duke bërë rreth 300 000 kilometër fluturim.
- Luftërat dhe statistik: Nga 1618 më 1905 janë bërë 1044 luftëra tokësore, 122 beteja detare, 490 rrethime, 44 kapitullime. Lufta më e gjatë llogaritet midis Venecas dhe Turqisë (55 vjet) në vitet 1644-1699, kuse lufta më e shkurtër është ajo midis Austrisë dhe Italisë e cila zgjati vetëm 6 orë.
- Zogu nuk ka shqisën e të nuhaturit dhe të shijes.
- Qukapiku në ditë han mesatarisht 3000 insekte.
- Nga barku i vajzës 20 vjeçare nga Devoni Jugor, Angli u nxor "topi" nga qimet e flokëve te saj të cilat i kishte gëlltitur, i rëndë 2,5 kg. Operimi u realizua në mars 1985.
- Kompjuterat modern janë ndërtuar duke u bazuar në sistemin nervor, por edhe kompjuteri modern nuk i afrohet as nivelit të nje zvarritësi.
- Një njeri i rritur merr frymë afërsisht 25 000 herë në ditë.

- Rreth 27% e ushqimit në vendet e zhvilluara përfundon në koshat e plerave.
- Mundësia për të të rënë rrufeja është 1 në 600,000.
- Në 1870 në Londër jetonin më shumë Irlandezë sesa në Dublin.
- Çdo 1 person nga 10 persona në botë jetojnë në ishull.
- Në Ditën e Nënave në SHBA bëhen më tepër telefonata personale se në çdo ditë tjetër në çdo shtet tjetër.
- Megjithëse në botë ka më shumë se 600 milionë telefona, gjysma e botës ende nuk ka bërë asnjë telefonatë.
- Gjysma e popullsisë së botës fiton vetëm rreth 5% të pasurisë në botë.
- Në 1750 në botë jetonin rreth 800 milionë njerëz, në 1850 nje miliard më tepër dhe në një 1950 edhe një tjetër miliard më tepër. Mastaj u deshën vetëm 50 vjet për tu dyfishuar dmth. 6 miliardë.
- Në Romën Antike veza gjendej vetëm në tavolinat më të rëndësishme dhe ruhej vetëm për miqtë më të rëndësishëm.